



Drejtuar: Operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk

Adresa: Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Ndërtim i mikrohapësirave publike në Tiranë”.

Numri i referencës së procedurës: REF-99190-12-14-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Ndërtim i mikrohapësirave publike në Tiranë”.

Fondi limit: 52,675,820.21 (pesëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet pikë njëzet e një) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21.01.2019, ora 12:00.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 51 datë 24.12.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo”

K02727202O

NUIS

L26310801C

NUIS

Vlera e ofertës = **39,408,951** (tridhjetë e e nëntë milion e katërqind e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” shpk

NUIS

K51712017A

NUIS

K01725001F

Vlera e ofertës = **48,038,272.80** (dyzetë e tetë milion e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë lekë pa TVSH.

3.Operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk

NUIS

K02017003I

Vlera e ofertës = **51,557,389** (pesëdhjetë e një milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk

NUIS

K02727202O

NUIS

L26310801C

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk dhe “Meteo” shpk nuk plotëson pikën 1, germa “c” të kriterëve të Veçanta të Dokumentave Standarte të tenderit: “Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1”, pasi u konstatua se Preventivi është paraqitur me ndryshim të strukturës, në njësi çka bie në kundërshtim me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, **Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike.**
- Shoqëria “Meteo” shpk për muajin Tetor 2018 ka paraqitur Formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të një subjekti tjetër dhe jo të shoqërisë “Meteo” sic është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, germa b) “*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë List pagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Nëntor 2017 - Nëntor 2018 shoqëruar me formularet e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.*”
- Deklarata mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, konkretisht Shoqëria “Meteo”, nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar, pasi brenda një deklarate janë të dhenat e dy subjekteve të ndryshme si dhe është bërë më datë 16.1.2019, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, germa b).
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqëruar për mjetet “Eskavator me goma”, të deklaruara në Shtojcën Nr.10, u konstatua se janë paraqitur vetëm me Deklarata Doganore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e

kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

2. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” shpk

NUIS

K51712017A

NUIS

K01725001F

- Shoqëria “Kacdedja” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 8, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Përgjithshme, pika 1.
- Shoqëria “Kacdedja” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 5, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “a”.
- Shoqëria “Kacdedja” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 7, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “b”.
- Shoqëria “Kacdedja” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 10, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “d”.
- Shoqëria “Kacdedja” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 11, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “dh”.
- Mosparaqitja e Shtojcës 10 nga Shoqëria “Kacdedja” shpk, rezulton se Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka mjetet e nevojshme për përmbushjen me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk**, me adresë: **Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **51,557,389** (pesëdhjetë e një milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.02.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 6157 Prot. datë 07.02.2019 në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim i mikrohapësirave publike në Tiranë”.

Me marjen e ankesës nga Operatori ekonomik i mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643

datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 6157/1 Prot. dt. 07.02.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma "a" të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 6157/2 Prot. datë 07.02.2019 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave (në vijim KSHA), i cili pasi u njoh me pretendimet e Shoqërisë "Aurora Konstruksion" shpk konkludoi në pranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresen me Nr. 6157/4 Prot. , datë 11.02.2019, (administruar ne dosjen e prokurimit).

Mbështetur në vendimin e mësipërm të KSHA, KVO më datë 11.02.2019 ka realizuar procesin e rivlerësimit dhe riklasifikimit të ofertave.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), në lidhje me rivlerësimin dhe riklasifikimin e ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

